

**Kontratë Shërbimi per: Internet GPON/ADSL dhe Telefoni**

Tiranë më, / /

	Ofruesi Shërbimit	Klienti
<b>Palët</b>	Vivo Communication sh.p.k. NIPT J82229005F ,me seli Kashar, Mëzez, autostrada Tir anë-Durres, Km 1, pranë godinës së Digitalb,Tiranë. Telefon: 044400123 Email: <a href="mailto:vivo.store@vivo.al">vivo.store@vivo.al</a>	Individ <input type="checkbox"/> Person Fizik (Pf) <input type="checkbox"/> Person Juridik (Pj) <input type="checkbox"/> Emri: _____ Nr.ID/NIPT: _____ Adresë/Seli: _____ Telefon: _____ Email: _____
<b>Lloji i kontratës dhe afati</b>	GPON <input type="checkbox"/> ADSL <input type="checkbox"/> Telefon <input type="checkbox"/> _____ MBPS _____ Minuta	Kohëzgjatja: _____ Muaj, Data fillimit të shërbimit ____/____/____
<b>Tarifa për Shërbimin</b>	_____ Lek/ Muaj	Tarifë regjistrimi per klientet fillestar: 1,000 Lek Tarifë Instalimi: _____ Lek
<b>Mënyra e Pagesës</b>	Cash <input type="checkbox"/>	Tranfertë Bankare <input type="checkbox"/> Banka _____ me NR. IBAN: _____
<b>Kontakt për Suport Teknik</b>	Telefon: <b>044400123</b>	Në rast se linjat janë të zëna, dërgoni një SMS në numrin e vënë në dispozicion nga VIVO Communications 0674040114

VIVO COMMUNICATIONS shpk		KLIENTI
<b>Emri Mbiemer</b>		
<b>Nënshkrimi</b>		



## TERMAT DHE KUSHTET E KONTRATËS

### 1. PËRKUFIZIME

- 1.1. **VIVO COMMUNICATIONS shpk:** Ofruesi i shërbimeve të telekomunikimit (ADSL, GPON, TELEFONI), që më poshtë do të jetë "VIVO".
- 1.2. **Klienti:** Përfituesi i shërbimeve të ofruara nga VIVO, sipas përcaktimeve të vendosura në këtë kontratë.
- 1.3. **Përdoruesi:** Çdo individ, person fizik dhe/ose juridik që lejonet nga Klienti për përdorimin e Shërbimit objekt i kësaj kontrate
- 1.4. **Palët:** VIVO dhe Klienti

### 2. OBJEKTI KONTRATES

- 2.1. Kjo kontratë përcakton kushtet,afatet, të drejtat dhe detyrimet që palët do të kenë kundrejt njëra-tjetrës si rrjedhojë e përdorimit nga Klienti të Shërbimeve të ofruar nga VIVO.
- 2.2. Shërbim konsiderohet lidhja e Klientit me rrjetin e VIVO-s nëpërmjet të cilit mundësohet ofrimi i Shërbimit për Klientin,sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë kontratë.

### 3. KOHEZGJATJA DHE AFATET

- 3.1. Kjo kontratë lidhet për një afat 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar nga data e nëshkrimit të saj nga palët dhe rinovohet automatikisht për të njëjtën periudhë e me të njëjtat kushte në mungesë të njoftimit paraprak 20 ditor nga përfundimi i afatit për mosrinovimin e saj nga Klienti. VIVO do të njoftojë Klientin me shkrim, poste elektronike ose telefon të paktën 30 ditë përpara, për përfundimin e afatit të Kontratës.
- 3.2. Data e fillimit të Shërbimit është data e aktivizimit të tij nga VIVO.

### 4. MENYRA E PAGESËS

- 4.1. Klientët e rinj duhet të parapagujnë 1,000 Lek për tarifën e rregjistrimit, e cila është e pakthyeshme, në çdo situatë.
- 4.2. Paguesa mujore për Shërbimet sipas llojit të Shërbimit paguhet nga Klienti përpara fillimit të periudhës së shërbimit kundrejt faturës së lëshuar nga VIVO.
- 4.3. Klienti mund t'i kryejë pagesat e përcaktuara, me lekë në dorë "CASH" pranë zyrave të shitjeve të VIVO, ose me transfer të bankare në numrat e llogarise bankare të VIVO, të shënuara në faturën mujore përkatëse, ose nëpërmjet Debitimit Direkt nga llogaria e tij rrjedhëse.

### 5. PËRGJEGJËSITË E VIVO-S

- 5.1. VIVO do të sigurojë për Klientin shërbimet, dhe pajisjet e përshkruara në vijim nga koha e instalimit të shërbimit dhe përgjatë të gjithë kohëzgjatjes së kësaj kontrate:
  - Në rast dëmtimi të modemit(ONU./Adsl) , VIVO do të kryejë zëvendësimin e pajisjes kundrejt pagesës.
  - Në rast ndërprerje shërbimi nga VIVO pagesa e kryer nuk do të kthehet, por kompensohet me kohën që ka qënë pa shërbim.
  - Klientet e rinj, si dhe klientet që përfitojnë aktualisht nga shërbimi Adsl dhe kalojnë në Gpon nëse parapagujnë abonimin për 3 muaj, modemi ONU/Adsl do të ofrohet falas në përdorim. Në momentin e zgjidhjes/përfundimit të kontratës, klienti duhet ta riktheje modemin në çdo rast.
  - VIVO nuk mban përgjegjësi për mbarëvajtjen e Modemit Onu/Adsl , nëse modemi ka dëmtime ose dëgjie në pajisje .
  - Klientët të cilët do të parapagujnë 1 muaj, duhet të pagujnë per Modemin (Onu 4,000 lek / Adsl 2,500 Lek) përfshirë tvsh, si dhe vlerën mujore të abonimit.
- 5.2. VIVO do t'i garantojë Klientit kapacitetin e kërkuar sipas kësaj Kontrate (garanton shpejtësinë e përcaktuar në kontratë) dhe do të garantojë suport telefonik për 16 nga 24 orë, nga dita e hënë deri të shtunë, ora 8:00-23:00. Në rast defekti dhe kur përcaktohet si e domosdoshme, nga kontaktet nëpërmjet suportit telefonik, VIVO do të ndërhyjë për riparim brenda 24 - 72 orë kohë pas njoftimit.

### 6. PËRGJEGJËSITË E KLIENTIT

- 6.1. Klienti do të parapagujë shërbimet sipas kësaj Kontrate, pa zbritje ose ndryshime, përfshirë shpenzimet lidhur me kryerjen e pagesave.
- 6.2. Klienti do të sigurojë që të gjitha pajisjet në përdorim prej tij dhe që lidhen me Shërbimet do të funksionojnë në përputhje me parametrat teknikë dhe me veçoritë e Shërbimit të VIVO -s, do të sigurojë hapësirën dhe energjinë e nevojshme për pajisjet e VIVO -s që do të shërbejnë për lidhjen e shërbimit, si dhe do të jetë përgjegjës për ruajtjen fizike të pajisjeve të VIVO -s të instaluar në ambientet e tij. VIVO do të riparojë ose zëvendësojë pajisjet e saj me shpenzimet e veta, me përjashtim të rasteve të dëmtimit të qëllimshëm dhe të rasteve të shkaktuara prej Forcave Madhore, zjarrit, shpëthimeve, energjisë elektrike, rrufeve ,ose shkaqe të tjera jashtë kontrollit të saj të ngjashme ose jo me sa u përshkrua më lart. Shpenzime të paarsyeshme që vijnë si pasojë e ndryshimit të vendndodhjes së Klientit, janë në ngarkim të Klientit.
- 6.3. **Në rast se klienti nuk kryen rinovimin e kontrates 1 muaj para përfundimit të afatit të saj, klienti duhet të kthejë pajisjet mbrapsht, në përfundim e afatit të kontrates.** Klienti është përgjegjës për përmbajtjen e çdo transmetimi që përdor Shërbimet ose çdo përdorim tjetër të shërbimeve, nga Klienti ose nga çdo person fizik dhe/ose juri dik që lejonet nga Klienti për përdorimin e Shërbimit një ("Përdorues"). Klienti pranon se ai dhe Përdoruesit nuk do të përdorin Shërbimet për qëllime të paligjshme, të ndërhyjnë në to, ose të shqetësojnë klientët e tjerë të rrjetit.
- 6.4. Klienti nuk do ketë në asnjë rast të drejtën të rishesë Shërbimin objekt të kësaj kontrate ose të prodhojë të ardhura në këtë mënyrë duke i dhënë hyrje në Shërbim ndonjë Përdoruesi tjetër.
- 6.5. Të gjitha njoftimet ndaj Klientit do të kryhen nga VIVO në adresën, Postare, elektronike e-mail, që Klienti i ka dhënë VIVO -s si adresë të vlefshme ose nëpërmjet numrit të telefonit. Klienti do të mbajë përgjegjësi personalisht për mosmarrjen e njoftimeve në rastin kur adresa e dhënë nuk është e vlefshme apo është bërë e pavlefshme gjatë kohës kur kjo kontratë është në fuqi. Klienti duhet të njoftojë VIVO -n për çdo ndryshim në të dhënat që i ka paraqitur VIVO -s me nënshkrimin e kësaj kontrate. Klienti ka përgjegjësinë për caktimin e personave të kontaktit për marrëdhëniet me VIVO -n.

### 7. ZGJIDHJA E KONTRATES DHE NDRËPRERJA E SHËRBIMIT

- 7.1. VIVO mund ta ndërpresë shërbimin dy (2) ditë nga njoftimi ndaj klientit, nëse klienti nuk paguan në kohë detyrimet financiare, ose nëse nuk respekton kushtet e kësaj Kontrate.VIVO mund ta zgjidhë Kontratën brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga njoftimi ndaj klientit për këto shkelje, klienti do të pagujë të gjitha detyrimet e vlefshme deri në datën e përfundimit të kontrates si dhe demshperblimin perkates.
- 7.2. Klienti mund ta zgjidhë këtë Kontratë:
  - pesë (5) ditë-pune pas njoftimit me shkrim për VIVO-n, nëse VIVO nuk jep shërbim për tre (3) ditë pune në vazhdimësi.
  - dhjetë (10) ditë-pune pas njoftimit me shkrim për VIVO-n, nëse VIVO nuk respekton kushtet dhe përcaktimet e kësaj Kontrate. Klienti duhet të pagujë të gjitha detyrimet e vlefshme deri në datën e zgjidhjes të kontratës.
  - Në rast se klienti kërkon të zgjidhi kontratën në mënyrë të njëanëshme, duhet të pagujë një penalitet prej 10,000 Lek.

### 8. MJETET E LIDHJES DHE PAJISJET

- 8.1. VIVO do të realizojë instalimin e linjës të nevojshme për të lidhur pikën e Klientit, sipas Kontratës. Shpenzime të paarsyeshme që vijnë si pasojë e ndryshimit të vendndodhjes së Klientit pas Datës së firmosjes së kontratës janë në ngarkim të Klientit.
- 8.2. Pajisjet e vendosura nga VIVO mbeten pronë e saj. Në rastin kur klienti nuk bën rinovim të kontratës, atëherë ai është i detyruar të kthejë pajisjen pranë kompanisë Vivo. Kjo përjashton rastet kur klienti e ka blerë pajisjen.
- 8.3. Klienti mban përgjegjësi ndaj VIVO, për vjedhjen e pajisjeve të instaluar që janë në posedim të tij. Në rast të një dukurie të tillë, klienti do të pagujë shumën e vlerës së pajisjeve që janë vjedhur.
9. **TË PËRGJITHSHME**
- 9.1. Kjo Marrëveshje i jep Klientit vetëm të drejtën e përdorimit të shërbimit sipas termave dhe kushteve të kësaj Kontrate.
- 9.2. Asnjë palë nuk mund t'ia ngarkojë këtë Kontratë një pale të tretë pa miratimin me shkrim nga pala tjetër. Megjithatë, VIVO mundet që pa miratimin e Klientit t'ia ngarkojë këtë Kontratë ose të drejtën për të marrë pagesat e caktuara këtu një filialit apo një nënkontraktori të VIVO-s. VIVO mund të nënkontrakttojë një pjesë ose gjithë punën që do të kryhet nga ajo nën këtë Kontratë, por do të mbajë përgjegjësinë për punën e nënkontraktuar.
- 9.3. Detyrimet e VIVO-s për paraqitjen sipas Kontratës janë vetëm ndaj Klientit dhe jo ndaj palëve të treta. Kushtet e kësaj Kontrate do të interpretohen dhe aplikohen sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë. Palët angazhohen të zgjidhin me mirëkuptim çdo problem që mund të lindë gjatë zbatimit apo interpretimit të kësaj kontrate. **Në rast se palët nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrveshjen me mirëkuptim, secila mund të drejtohet për shqyrtim AKEP dhe Gjykatës së Rrethit ku është lidhur kontrata.** Kjo është kontrata e plotë mes palëve për shërbimet e caktuara këtu dhe zëvendëson gjithë marrëveshjet e mëparshme, propozimet, përfaqësimet, pohimet, ose kuptimet, qoftë me shkrim ose me gojë,përsa u takon këtyre shërbimeve, asnjë ndryshim i plotë ose i pjeshëm apo heqja e termave të kësaj. Kontrata nuk do të jetë e zbatueshme nëse nuk është e firmosur nga dyja palët.